

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë

Varshavë, Poloni

Nga data 23 deri 26 shtator 2013

Rezolutë mbi koordinimin e zbatimit të ligjit në shkallë ndërkombëtare

Duke rikujtuar se rezolutat e miratuara gjatë Konferencave të 29-të, të 33-të dhe të 34-t:

- Inkurajojnë autoritetet e ngarkuara me zbatimin e ligjit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, që të shtojnë përpjekjet për mbështetjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të punojnë me organizatat ndërkombëtare me qëllim përforcimin e mbrojtjes së të dhënave në shkallë botërore;
- Marrin në mbrojtje miratimin e Rekomandimit të Organizatës së bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik (OCDE) në lidhje me bashkëpunimit ndërkufitare në zbatimin e legjislacioneve që mbrojnë jetën private;

Duke rikujtuar që Grupi i punës i ngarkuar për koordinimin e zbatimit të ligjit në shkallë ndërkombëtare, është ngritur për kohësisht në Konferencën e 33-të, për të përpunuar një kuadër përkatës për lehtësimin e koordinimit dhe paraqitjen e tij gjatë Konferencës së 34-t;

Duke mbajtur parasysh faktin se grupi i punës ka paraqitur një kuadër që përmban gjashtë parime që gjejnë zbatim në koordinimin e rekomanduar;

Duke rikujtuar gjithashtu që pjesëmarrësit në Konferencë e 33-të, kanë miratuar një rezolutë në zbatim të së cilës ata duhet të kërkojnë që të garantohet se organizatat interesohen për zbatimin e ligjit dhe koordinimin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, kanë mundësinë të mblidhen të paktën një herë në vit dhe duke mbajtur parasysh se disa mbledhje të mëvonshme janë organizuar në Uashington DC.;

Të ndërgjegjshëm se disa shembuj të kohëve të fundit kanë treguar edhe një herë se praktikat e shoqërive të mëdha botërore, apo cënimet ndaj sigurisë, që prekin sistemet e tyre të informacionit, mund të përhapen negativisht me shpejtësi mbi të dhënat personale të një numri të madh individësh, kudo nëpër botë;

Mbështetur mbi progresin e konsiderueshëm të arritur gjatë viteve të fundit, në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, për të përmirësuar marrëveshjet që parashikojnë bashkëpunim ndërkombëtar, në zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, përfshirë përpjekjet e bëra nga APEC-u, autoritetet e mbrojtjes së të dhënave të Grupit të punës së nenit 29, OCDE-së, Këshillit të Evropës, rrjetit të autoriteteve frankofone, rrjetit iberik-amerikan dhe Rrjetit Global të Zbatimit të Privatësisë (GPEN);

Duke dalë në përfundimin se një koordinim më i mirë do të përforcojë efektshmërinë e autoriteteve të ngarkuara me zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në rastet ku përfshihet përpunimi i të dhënave personale në shumë vende;

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë vendos të inkurajojë paraprakisht përpjekjet që synojnë garantimin e koordinimit të hetimeve ndërkombëtare dhe zbatimin më të efektshëm të ligjit në rastet përkatëse dhe më saktësisht:

1. **T'i kërkojë** Grupit të punës së ngarkuar me koordinimin e zbatimit të ligjit në shkallë ndërkombëtare, të bashkëpunojë me rrjetet e tjera me qëllim hartimin e një qasjeje të përbashkët për përpunimin e dosjeve ndërkombëtare dhe koordinimin e zbatimit të ligjit dhe ta paraqesë në një dokument të kuadrit shumëpalësh, të cilin pjesëmarrësit do të mund ta miratojnë në Konferencën e 36-të. Kjo qasje, e cila do të frymëzohet nga kuadri i koordinimit të zbatimit të ligjit në shkallë ndërkombëtare, paraqitur gjatë Konferencës së 34-t dhe punimeve të GPEN-it, do të zbatohet në shkëmbimet e informacionit në lidhje me zbatimin e ligjit dhe të trajtimit për ata të cilëve do t'u jepet. Këto punime nuk kanë si objekt zëvendësimin e kushteve dhe mekanizmave kombëtare dhe rajonale, të cilat rregullojnë shkëmbimin e informacionit, e as t'u kundërvihet marrëveshjeve të ngjashme të nënshkuara nga rrjete të tjera.
2. **Të mbështesë** krijimin e një platforme informacioni të siguar, duke ofruar një "vend të mbrojtur" ku autoritetet e ngarkuara me zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale të mund të shkëmbejnë informacione konfidenciale dhe të lehtësojë vënien në jetë të një ndërhyrjeje të përqendruar të zbatimit të ligjit, në përmbushje të mekanizmave të tjerë të koordinimit, duke sjellë një vlerë të shtuar kuadrit të zbatimit të ligjit në shkallë ndërkombëtare.

Shënim shpjegues

Rezoluta mbështetet tek rezolutat e miratuara më parë, duke inkurajuar bashkëpunimin në zbatimin e ligjit në shkallë ndërkombëtare. Të gjithë anëtarët e Konferencës ndërkombëtare, janë të ftuar të bashkojnë përpjekjet e tyre për arritjen e objektivave të rezolutës, e cila synon të nxisë mekanizmat ekzistues, t'i zgjerojë e t'i përmirësojë, gjithë duke u kujdesur për përditësim, kërkimin dhe vlerësimin e mënyrave të reja të koordinimit të zbatimit të ligjit në shkallë ndërkombëtare.

Rezoluta pranon se Rrjeti Global e Zbatimit të Privatësisë (GPEN) mbetet i vetmi rrjet botëror i dedikuar ekskluzivisht për bashkëpunimin në zbatimin e ligjit, në të cilin mund të marrin pjesë të gjitha autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ai i nxit që t'i bashkohen GPEN-it dhe të japin kontribut në përmirësimin e efektshmërisë së tij.

Për të ndihmuar në ndërtimin paraprak mbi përpjekjet ekzistuese dhe paraqitjen e mekanizmave konkrete që bëjnë të mundur dhe lehtësojnë bashkëpunimin në zbatimin e ligjit në shkallë ndërkombëtare, Komisioneri për Informacionin i Mbretërisë së Bashkuar, do të organizojë mbledhjen e tretë të koordinimit të zbatimit të ligjit në shkallë ndërkombëtare, në Mançester, në prill të 2014.

Duke mbajtur parasysh zhvillimin teknologjik dhe lehtësinë e shkëmbimit të të dhënave personale në të gjithë botën, autoritetet e ngarkuara me zbatimin e ligjeve në këtë fushë, duhet të përcaktojnë mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për të koordinuar aksionet e tyre, në mënyrë që t'i përgjigjen si duhet kërkesave të qytetarëve në vendet përkatëse, në kapitullin e mbikëqyrjes së efektshme të këtij fenomeni.

Janë caktuar mekanizma bashkëpunimi dhe koordinimi, por autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale duhet të drejtohen nga organizata të tjera ndërkombëtare të rëndësishme, për shembull APEC-u, autoritetet e mbrojtjes së të dhënave anëtare të Grupit të punës së nenit 29, Këshillit të Evropës dhe OCDE-së dhe të frymëzohen për hartimin e kuadrit të tyre ligjor dhe teknik.

Meqenëse disa ligje në fuqi përcaktojnë kufizime për sa i përket shkëmbimit të informacioni mbi hetime të mundshme që janë duke u kryer, autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, mund t'i përmbahen disa kushteve përpara se të komunikojnë informacion organizatave të huaja. Kjo etapë është lehtësuar shpesh me anë të protokolleve të mirëkuptimit apo marrëveshjeve rajonale. Duke përvetësuar këtë lloj qasjeje shumëpalëshe, ne mund të lehtësojmë barrën administrative, të përshpejtojmë procesin dhe të favorizojmë një shkëmbim më të madh të informacionit në lidhje me zbatimin e ligjit. Autoritetet që dëshirojnë t'u drejtohen protokolleve të mirëkuptimit apo marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalëshe dhe rajonale, për arsye ligjore apo arsye të tjera, duhet të vazhdojnë ta bëjnë këtë. Punimet e propozuara në pikën 1 si më lart, nuk përjashtojnë këto rrugë.

Platforma e informacionit të propozuar në këtë rezolutë, synon të mbështesë punimet e autoriteteve anëtare të GPEN-it dhe duhet të jetë i mbështetur mbi një protokoll me shumë nivele, sipas të cilit autoritet mund të marrin vendime në lidhje me shkëmbimin e informacionit me homologët e tyre, duke pasur garancinë se ato kanë marrë përsipër angazhime të ndërsjella dhe kanë funksione e detyrime të njëjta.

Duket pak e mundur që një qasje e përgjithshme të mund të bëhet, por kjo nuk duhet të pengojë autoritetet që të mundohen të dokumentojnë konceptet përbashkëta që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe të përmirësojnë koordinimin dhe bashkëpunimin.